


10 korrik 1943 - Krijimi i Shtabit të Përgjithshëm të Ushtrisë Nacionalçlirimtare , datë që nuk duhet harruar

70 vjet nga krijimi i Ushtrisë Antifashiste Nacionalçlirimtare

*Nga Rrahman PARLLAKU**

Në këtë shkrim nuk kam marrë përsipër të flas gjatë për fillnisjen dhe vazhdimësinë e Ushtrisë

Kombëtare Shqiptare, pasi kjo u takon historianëve, por të përkujtoj e të them diçka për një nga datat më të rëndësishme në historinë e Ushtrisë Shqiptare... (Faqe 3)



Veterani

ORGANIZATA E BASHKUAR E VETERANËVE TË LUFTËS ANTIFASHISTE NACIONALÇLIRIMTARE TË POPULLIT SHQIPTAR (OBVL)
GAZETË DYJAVORE. NR. 60 (291) 1-15 KORRIK 2013. ÇMIMI: 20 LEKË

Kryeredaktor: Halil RAMA

Adresa: Ministria e Mbrojtjes, Tiranë.

Email: veterani.obvl@yahoo.com

Zgjedhjet, shqiptarët kanë arsye të jenë krenarë

Shtetet e Bashkuara të Amerikës kanë përgëzuar shqiptarët për pjesëmarrjen e tyre masive në zgjedhjet e 23 qershorit, duke nxitur autoritetet që të finalizojnë numërimin dhe të trajtojnë çdo ankimum në mënyrë transparente, të shpejtë dhe në përputhje me shtetin ligjor.

Ambasadori i SHBA në OSBE, Ian Kelly ka mbajtur një fjalë Përpara Këshillit të Përhershëm në Vienë, në të cilën thekson se tashmë që zëri i shqiptarëve është dëgjuar, palët duhet të punojnë sëbashku në mënyrë konstruktive për të çuar përpara zhvillimin demokratik dhe ekonomik të Shqipërisë. "Puna e vështirë e ndërtimit të demokracisë nuk mbaron pasi numërohen votat dhe shpallen fituesit. Udhëheqësit politikë do të gjykojnë jo nga ajo që thonë, por nga ajo që bëjnë. Pas formimit, nxsisim qeverinë e re që të vazhdojë të forcojë shtetin ligjor, të rrisë standardet e të drejtave të njeriut, të promovojë qeverisje transparente dhe llogaridhënese, të promovojë zhvillimin ekonomik dhe të punojë drejt reformash të qëndrueshme demokratike në rrugën konsensuale të anëtarësimit në Bashkimin Europian. Ky është një proces i cili, ashtu si përpara këtyre zgjedhjeve, do të kërkojë që edhe ata në opozitë të luajnë një rol konstruktiv, dhe ne kërkojmë angazhimin e tyre edhe në të ardhmen e Shqipërisë." - thuhet në deklaratë.

Deklarata mbështet po ashtu edhe misionin e vëzhgimit zgjedhor të OSBE/ODIHR si dhe vlerësimin e përbashkët nga ODIHR, Asambleja parlamentare e OSBE-së, dhe Asambleja Parlamentare e Këshillit të Europës, të cilët vlerësuan se qytetarët shqiptarë kanë shprehur lirisht vullnetin e tyre në kutinë e votimit.

Ndërkohë, anëtari i Dhomës Përfaqësuese të Kongresit amerikan, Eliot Engel, ka vlerësuar se me zgjedhjet e suksesshme "Shqipëria, edhe njëherë ka demonstruar se është demokraci në lulëzim".

(vijon në fq.5)

Brukseli: MSA për Kosovën, anëtarësim për Serbinë

BE, DRITË JESHILE KOSOVËS PËR MSA-në



Egjipti njeh Kosovën!

Kosova shpalli pavarësinë e saj nga Serbia më 17 shkurt të vitit 2008 dhe tashmë njëqind vende e kanë njohur atë

FAQE 8

Promovohet libri me kujtime i ish-Sekretarit amerikan të Mbrojtjes

Rumsfeld: I lumtur për botimin në shqip

FAQE 4

U BOTUA LIBRI I SHUMEPRITUR "POETI I MALESISE"

"Artisti i Merituar" Prendush Gega - poeti i Kabashit

Nga Xhemal MECI

FAQE 6-7

Gjermania këmbënguli se duhej dërguar një sinjal mosmiratimi nga BE-ja lidhur me shtypjen e protestave anti-qeveritare në Turqi

Shtyhen bisedimet për anëtarësimin e Turqisë në BE

FAQE 8

PERKUJTOJME, USHTARAKUN DHE VETERANIN SHEMBULLOR

Pesë vjet pa Mehmet Ukshin Gjongecin

Nga ALI DEMUSHI

FAQE 4

Shefat e diplomacive të vendeve anëtare të Bashkimit Evropian vlerësuan në Luksemburg progresin e arritur në bisedimet Kosovë-Serbi

BE, dritë jeshile Kosovës për MSA-në

Gjermania njeh progresin që Kosova dhe Serbia kanë arritur në sajë të zbatimit të marrëveshjes për normalizimin e raporteve mes dy vendeve, që ishte vënë si kusht për integrimet e mëtejme të dy vendeve në Bashkimin Evropian

Këshilli i Ministrave të BE-së jep dritën jeshile Kosovës për fillimin e negociatave të Marrëveshjes së Stabilizim-Asocimit.

Draft-rezoluta e Këshillit të Ministrave të BE-së, që ka parë Radio Evropa e Lirë, shkruan se "Kosova është e gatshme të nis negociatat për Marrëveshjen e Stabilizim-Asocimit dhe pa paragjykim për pozitën e vendeve anëtare ndaj statusit [të Kosovës], miraton vendimin për autorizimin e hapjes së negociatave".

Shefat e diplomacive të vendeve anëtare të Bashkimit Evropian vlerësuan në Luksemburg progresin e arritur në bisedimet Kosovë-Serbi, dhe nivelin e zbatimit të marrëveshjes për normalizimin e raporteve.

Po ashtu edhe kjo draft-rezolutë është miratuar nga ministrat e jashtëm të BE-së.

Më pas, rezoluta iu dërgua si rekomandim Këshillit Evropian i cilia ka formalizuar hapat e mëtejme gjatë mbledhjes më 27 dhe 28 qershor në Bruksel.

Gjermania njeh progresin që Kosova dhe Serbia kanë arritur në sajë të zbatimit të marrëveshjes për normalizimin e raporteve mes dy

vendeve, që ishte vënë si kusht për integrimet e mëtejme të dy vendeve në Bashkimin Evropian.

Ministri i jashtëm gjerman Guido Westerwelle tha para takimit të ministrave të jashtëm të BE-së në Luksemburg se Prishtinës dhe Beogradit u duhet njohur rezultatin e punës që kanë bërë në muajt e fundit për relaksimin e raporteve.

"Dua të them në mënyrë eksplicite, se Serbia por edhe Kosova, së fundi kanë treguar gatishmëri dhe energji, por edhe forcë për të zbatuar marrëveshjen e normalizimit [të raporteve]", tha ai.

"U duhet njohur këtë [progres]. Ne mund të themi se Serbia dhe Kosova kanë bërë shumë përpjekje për të zbatuar në terren, atë që është vendosur në nivelin politik. Dhe unë dua ta njoh në mënyrë eksplicite këtë gjë", u tha medieve shefi i diplomacisë gjermane Westerwelle para nisjes së takimit me homologët e tij evropian.

Draft-rezoluta e Këshillit të Ministrave të BE-së, që ka parë Radio Evropa e Lirë, rekomandon që Serbia të nisë negociatat për anëtarësim.

Pas takimit të 27 dhe 28 qershorit, dhe rekomandimeve që nxirren aty, draft-rezoluta shkruan se "takimi i parë ndër-qeveritar me

Serbinë të mbahet më së voni në Dhjetor 2013"

Por si Kosova ashtu edhe Serbia, vazhdojnë të kenë njëra-tjetrën kusht për ecjen e mëtejme përpara në integrimet evropiane.

"Këshilli nënvizon se përmirësimi i vazhdueshëm i raporteve të qëndrueshme dhe të prekshme mes Serbisë dhe Kosovës, është i nevojshëm që të dyja vendet të mund të ecin drejt rrugës së tyre evropiane, përdërisa shmangen nga pengimi i përpjekjeve të tjetrit".

"Në këtë kontekst, Komisioni Evropian dhe Përfaqësuesja e Lartë {Catherine Ashton} ftohen që të vazhdojnë t'i raportojnë Këshillit për progresin e Serbisë/Kosovës në zbatimin e marrëveshjes së 19 prillit dhe planit të zbatimit të saj", shkruan draft-rezoluta që ka parë Radio Evropa e Lirë.

Se gjasat janë të mëdha që kjo draft-rezolutë do të miratohet e përdryshuar, sugjeron edhe ministri i jashtëm i Suedisë Carl Bildt.

Për fillimit të takimit në Luksemburg, ai i tha medieve se nuk ka asgjë të paqartë në progresin që kanë arritur Prishtina dhe Beogradi, në përmbushjen e kushteve që ua ka parashtruar Bashkimi Evropian për të relaksuar raportet. "Mendoj se fak-



tet janë goxha të qarta në këtë rast. Ne u kemi thënë se ata duhet të arrijnë disa gjëra specifike, dhe ata i kryen këto punë. Dhe kjo është e vërtetë si në rastin e Serbisë ashtu edhe Kosovës, andaj është e rëndësishme që ne t'i përmbahemi pjesës sonë të marrëveshjes", tha Bildt.

Në Beograd ndërkaq zëvendëskryeministri Aleksandar Vučić deklaroi se Serbia pret që të merr datën konkrete për nisjen e negociatave për anëtarësim në BE.

Gjatë një interviste për B92, zëvendësi i parë i qeverisë së Serbisë tha se ditët në vijim janë tejet të rëndësishme për këtë vendim të BE-së, ndërsa parlamenti gjerman pritet të merr vendim për këtë punë më 27 qershor, se a do të mbështes apo jo dhënien e datës për Serbinë. "Të jem sa më i sqartë, sepse nuk e di se kush kujt i dërgon raporte, por mendoj se ne do të fitojmë datën, sepse Serbia e ka merituar atë", ka thënë Vučić për televizionin B92.

STEFAN FYLE: GJITHÇKA ËSHTË GATI QË KOSOVËS T'I HAPET RRUGA PËR INTEGRIME EVROPIAN

Brukseli: MSA për Kosovën, anëtarësim për Serbinë

Ministrat e Jashtëm të Bashkimit Evropian janë pajtuar që të hapen negociatat mes BE-së dhe Kosovës për Marrëveshjen e Stabilizim-Asociimit.

Komisioneri evropian për Zgjerim Stefan Fule ka deklaruar më 25 qershor gjatë një konference për shtyp pas takimit të ministrave të jashtëm evropian në Luksemburg, se gjithçka është gati që Kosovës t'i hapet rruga për integrimet evropiane.

"Ministrat janë pajtuar që të hapen negociatat për Marrëveshjen e Stabilizim Asociimit me Kosovën. Mandati për këto negociata është caktuar, dhe ai formalisht do të miratohet të premten, [po atë ditë] edhe do të miratohen edhe konkluzionet e Këshillit të Evropës", ka thënë komisionari Fule. Sipas tij, negociatat për MSA-në me Kosovën "mund të nisnin menjëherë" pasi ato të jenë adoptuar nga Këshilli i Evropës.

Serbia në anën tjetër ka marrë po ashtu vizën nga kryediplomatët e vendeve anëtare të unionit, për hapjen e negociatave për anëtarësim në BE.

Komisionari Stefan Fule tha se do të varet nga Këshilli i Evropës që të miratohet kornizën e tashme kohore nëse konferenca ndër-qeveritare do të zhvillohet "më së largu në janar të vitit të ardhshëm".

"Por kjo nuk e përjashton



mundësinë që ajo [konferenca ndër-qeveritare] të ndodh edhe më herët", tha Fule.

Qeveritë e vendeve anëtare të Bashkimit Evropian kanë arritur një pajtim paraprak që të hapin negociatat me Serbinë.

Rezultati i takimit të sotëm në Luksemburg, kërkon konfirmim të liderëve evropian të cilët pritet të takohen të enjten dhe të premten në Bruksel.

Komisionari për zgjerim i Bashkimit Evropian ka përshëndetur rezultatin që kanë prodhuar kryediplomatët e vendeve anëtare të BE-së, duke e quajtur si "provë e kredibilitetit pas hapave të paprecedentë që u ndërmorën në normalizimin [e marrëdhënieve] me Kosovën".

Ministri i Punëve të Jashtme të Gjermanisë Guido Westerwelle tha pas takimit në Luksemburg se përpjekjet e Prishtinës dhe Beogradit për të normalizuar raportet, duhet të pasojnë me një reagim nga BE-së. "Kjo do të thotë se Këshilli i

Evropës këtë javë do të vendos nëse do të nxjerr një datë konkrete [për Serbinë], të cilën ne do ta mbështesim. E tillë është situata në këtë moment. Mos prisni sot vendimin përfundimtar, sepse kurrë nuk është lajmëruar, dhe as që ishte paralajmëruar se në fund të javës do të merret vendimi në Këshillin Evropian".

"Ne vetëm japim rekomandime shefava tanë të qeverive. Kurse sa i përket Parlamentit të Gjermanisë...mendoj se kolegët e mi kanë po ashtu një qasje konstruktive për këtë temë", ka thënë shefi i diplomacisë gjermane Guido Westerwelle.

Homologu i tij nga Danimarka Nikolaj Vammen tha se Kosova dhe Serbia kanë arritur përparime gjatë negociatave. "Nga perspektiva e Danimarkës, ne kemi parë një përparim të theksuar ndërmjet të Kosovës dhe Serbisë. Plaga e përgjishmë e Evropës tani po shërohet, dhe të dy shtet mund të normalizojnë raportet e tyre. Ato kanë plotësuar kërkesat që Evropa ua ka parashtruar, dhe Danimarka vlerëson se është e rëndësishme që BE-ja t'i dërgoj sinjal pozitiv atyre, dhe që sa më parë të jetë e mundur të hapen negociatat me Serbinë, dhe të ndërmerr hapat e mëtejme për Kosovën", tha ministri Vammen pas takimit.

Thaçi e Daçiç zotohen për zbatimin e marrëveshjes

Kryeministrat e Kosovës dhe Serbisë, Hashim Thaçi e Ivica Daçiç u zotuan për zbatim të plotë të marrëveshjes për normalizimin e marrëdhënieve ndërmjet të dyja vendeve. Kryeministri Thaçi tha në Prishtinë se, kjo marrëveshje u ka hapur Kosovës dhe rajonit një rrugë të sigurt evropiane. Ndërsa, Kryeministri Daçiç, tha në Bruksel se pret një vendim të pakushtëzuar për fillimin e negociatave për anëtarësim në Bashkimin Evropian. Dje, ministrat e Jashtëm të Bashkimit Evropian ranë dakord të fillojnë negociatat për Marrëveshjen e Stabilizim-Asociimit me Kosovën, ndërsa në janar të vitit që po vjen ato për anëtarësim të Serbisë.

Ratifikimi i marrëveshjes për normalizimin e marrëdhënieve ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, në Kuvendin e Kosovës duket të mos jetë ndonjë problem i madh. Subjektet politike parlamentare me përjashtim të Vetëvendosjes janë pajtuar që ta mbështesin ratifikimin e marrëveshjes. Kryeministri Hashim Thaçi në mbledhjen e qeverisë bëri të ditur se një takim i tillë i liderëve politikë ka ndodhur të martën, ku është arritur pajtimi edhe për datën e zgjedhjeve lokale më 3 nëntor.



10 KORRIK 1943 - KRIJIMI I SHTABIT TË PËRGJITHSHËM TË USHTRISË NACIONALÇLIRIMTARE, DATË QË NUK DUHET HARRUAR

70 vjet nga krijimi i Ushtrisë Antifashiste Nacionalçlirimtare

Krijimi i Shtabit të Përgjithshëm 70 vjet më parë, më 10 Korrik 1943, me vendim të Këshillit të Përgjithshëm Antifashist Nacionalçlirimtar e zgjidhi problemin e drejtimit të përqëndruar të Ushtrisë. Kjo do të përkujtohet si dita e themelimit të Ushtrisë Antifashiste Nacionalçlirimtare. Në përbërjen e Shtabit të Përgjithshëm u emëruan figurat më të afirmuara udhëheqëse të Luftës



Rrahman PARLLAKU*

Në këtë shkrim nuk kam marrë përsipër të flas gjatë për fillnisjen dhe vazhdimësinë e Ushtrisë Kombëtare Shqiptare, pasi kjo u takon historianëve, por të përkujtoj e të them diçka për një nga datat më të rëndësishme në historinë e Ushtrisë Shqiptare, atë të krijimit të Ushtrisë Antifashiste Nacionalçlirimtare. Gjykoj se kjo datë do të zerë vendin e merituar në analet e historisë së kombit tonë.

Viti 1943 shënoi rritje në përmasa të mëdha të Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare. Në gjithë vendin ishin krijuar njësitë guerile, çeta e batalione partizane. Luftimet zhvilloheshin, jo të veçuara nga çetat e batalionet, por të përbashkëta e të koordinuara brenda qarkut. Po në korrik të atij viti filluan të zhvilloheshin veprime luftarake të përbashkëta edhe në mes qarqeve të ndryshme, siç ishin luftimet e Përmetit, ku morën pjesë forcat e Gjirokastresë, Korçës e Beratit.

Shtimi i radhëve të Ushtrisë partizane, çlirimi i krahinave të ndryshme, jehona e luftës të përhapur në të gjithë vendin u ndien edhe në botën e jashtme dhe u vlerësuan nga Fuqitë e Mëdha të Aleancës Antifashiste. Ata e njohën Luftën Antifashiste Nacionalçlirimtare të popullit shqiptar, dërguan përfaqësuesit e tyre pranë Shtabit të Përgjithshëm, Zonës së Parë Operative, qarqeve e njësiteve që ta ndiqnin nga afër e ta ndihmonin atë. Ky nivel i ri i Luftës Antifashiste kërkonte që Ushtria të kishte një strukturë të re organizative, të njëjtë si për repartet sulmuese dhe teritoriale, ashtu edhe për krijimin e njësiteve taktiko-operative për veprime në të gjithë vendin.

Rritja sasiore dhe cilësore e ushtrisë kërkonte drejtim unik dhe bashkërendim të veprimeve luftarake në shkallë vendi.

Hap cilësor në drejtim të luftimeve

Krijimi i Shtabit të Përgjithshëm 70 vjet më parë, më 10 Korrik 1943, me vendim të Këshillit të Përgjithshëm Antifashist Nacionalçlirimtar e zgjidhi problemin e drejtimit të përqëndruar të Ushtrisë. Kjo do të përkujtohet si dita e themelimit të Ushtrisë Antifashiste Nacionalçlirimtare. Në përbërjen e Shtabit të Përgjithshëm u emëruan figurat më të afirmuara udhëheqëse të Luftës. Komandant i Shtabit u caktua Spiro Moisiu, që ishte jo vetëm luftëtar i afirmuar, por edhe i paisur me kulturë ushtarake.

Me krijimin e Shtabit të Përgjithshëm u bë një hap cilësor në drejtim të luftimeve, u bë kalimi nga një ushtri partizane me bazë rajonale në një ushtri mbarëkombëtare me strukturë organizative që t'i përgjigjej jo vetëm stadi të arritur, por edhe perspektivës të kalimit në ushtri të rregullt.

Shtabi i Përgjithshëm mori masa të menjëherëshme për organizimin e strukturave ushtarake si të forcave operative, teritoriale dhe të administratës ushtarake. Në forcat operative hynin brigadat sulmuese, që ishin të destinuara të vepronin në gjithë hapësirën e territorit të vendit dhe forcat teritoriale që vareshin nga komandat e qarqeve.

Në krahinat e çliruara qarqet kishin krijuar organet administrative ushtarake, komandat e vendit në krahina, spitale, depo furnizimi etj.

Ky organizim ushtarak e justifikoi plotësisht veten në realizimin e detyrave luftarake nga njësitë e repartet, ku u kombinua mirë drejtimi nga Shtabi i Përgjithshëm me iniciativën e gjerë në veprimet luftarake nga vetë komandat e njësiteve e reparteve, komandat e qarqeve dhe të Zonës së Parë Operative që përfshinte qarqet Vlorë dhe Gjirokastër. Kjo iniciativë ishte më se e domosdoshme, pasi luftimet zhvilloheshin pa front të rregullt, mjete teknike të ndërlikueshëm e të drejtimit, mungonin kryesisht, komunikimi me Shtabin e Përgjithshëm me ndërprerje të gjatë kohe.

Partizanët përballuan vështirësi mbinjerëzore

Shtabi i Përgjithshëm, me gjithë



kushtet tepër të vështira në të cilat vepronte dhe mungesën që kishte për ushtarakë të mirëfilltë, përgaditi e dërgoi disa udhëzime normative për rregullimin e jetës në reparte, drejtimin e luftimit, rregullin e disiplinën ushtarake, të kombinimit të disiplinës së ndërgjegjshme në zbatimin e detyrave etj.

Është me vend të theksojmë se kjo ishte disiplinë shembullore, e vetëpranuar jo vetëm në marrëdhënjet mes luftëtarëve, por edhe me popullin dhe nuk e thyenin atë qoftë edhe kur duhej dhënë jeta.

Masat organizative dhe ushtarake që mori Shtabi i Përgjithshëm, përgaditja dhe edukimi i forcave partizane me ndjenjën e lartë të përgjegjësisë për çlirimin e vendit nga zaptuesit, i bënë repartet dhe njësitë e Ushtrisë Antifashiste Nacionalçlirimtare të përballojnë vështirësi, do të thoshja mbinjerëzore.

Vetëm ai që ka përballuar vështirësitë e Operacionit Nazist të Dimrit 1943-"44 e di fort mirë këtë, të tjerët vështirë ta kuptojnë. Kjo përgatitje shpirtërore dhe vendosmëri për kalimin e vështirësive bëri që repartet e njësitë e dështuara rëndë ta marrin shumë shpejt veten në pranverën e vitit 1944 e të hidhen në sulm që e befasoji keqas armikun. Këtë e kanë shprehur edhe përfaqësuesit e aleatëve në shkrimet e kujtimet e tyre, shumë prej të cilëve kanë ardhur edhe në Shqipëri.

Ndryshimet organizative ishin të karakterit operativo-strategjik

Shtimi i shpejtë i reparteve e njësiteve të Ushtrisë Antifashiste Nacionalçlirimtare, sidomos krijimi i brigadave sulmuese, veprimet e tyre luftarake në hapësira të mëdha

të territorit, çlirimi i shumë krahinave të vendit, i mbylli nazistët në qytetet dhe në ruajtjen e disa pikave bregdetare e të rrugëve kryesore. Në këto kushte, Shtabi i Përgjithshëm mori masa për ndryshime organizative e të drejtimit të njësiteve që ishin të karakterit operativo-strategjik, ndryshime në zhvillimin e veprimeve luftarake, kalimin nga luftimet pa front të rregullt në kryerjen e luftimeve dhe operacioneve në front të gjerë.

Këto masa të parashikuara nga Shtabi i Përgjithshëm, u aprovuan në Kongresin Antifashist të Përmetit më 24 Maj 1944. Kështu u krijua Komanda e Përgjithshme, u vendosën gradat ushtarake, u krijuan njësitë operative strategjike.

Të gjitha këto masa i jepnin Ushtrisë Antifashiste Nacionalçlirimtare karakterin e një ushtrie të rregullt, me perspektivë për kalimin në mësymjen e përgjithshme për çlirimin e plotë të vendit.

Komandant i Përgjithshëm i saj u caktua Enver Hoxha, i cili përqëndroi në duart e tij edhe shumë detyra të tjera si atë të Sekretarit të Parë të Partisë, atë të kryeministrit, të ministrit të jashtëm etj. Por siç dihet ai nuk ka pasur as njohuritë minimale si ushtarak, prandaj detyrën e drejtimit të Ushtrisë deri në çlirimin e vendit e kreu Shtabi i Përgjithshëm, i përforcuar me kuadro të përgaditura, si dhe komandat e njësiteve e të reparteve.

Nazistët e bashkëpunëtorët e tyre bënë tentativën e fundit në shkallë të madhe me Operacionin e Qershorit '44 duke grumbulluar forca të shumta për të goditur, dëmtuar e penguar Ushtrinë Antifashiste Nacionalçlirimtare në zhvillimin e forcimin e mëtejshëm të saj dhe luftën për çlirimin e vendit. Por hovi

që kish marrë lufta, shtimi e forcimi i vazhdueshëm i Ushtrisë Antifashiste Nacionalçlirimtare, e thyen shpejt këtë përpjekje të dëshpëruar të armikut në shkallë vendi. Mbas kësaj Ushtria Antifashiste Nacionalçlirimtare kaloi në mësymjen e përgjithshme, gjë që çoi në çlirimin e vendit nga pushtuesi.

Ushtria Nacionalçlirimtare shqiptare luajti rol të rëndësishëm në Kosovë dhe në krahina të tjera të ish Jugosllavisë. U zbatuan me vendosmëri detyrat e marra nga Shtabi i Përgjithshëm i Ushtrisë NÇL për të ndihmuar popullin e Kosovës për çlirimin e tij, duke ndikuar në rritjen e pjesëmarrjes të sa më shumë kosovarëve në këtë luftë të madhe, për të patur të drejtën e vetëvendosjes pas mbarimit të saj. Po ashtu u zbatua detyra për ngritjen e pushtetit, pasi shumicën në këshilla e kishin shqiptarët. Brigadat partizane të Ushtrisë Nacionalçlirimtare shqiptare dhanë një kontribut të veçantë në Kosovë. Në zbatim të detyrave të Shtabit të Përgjithshëm të Ushtrisë Nacionalçlirimtare shqiptare, brigadat dhe formacionet tjera partizane të kësaj ushtrie u angazhuan për të penguar dhe dëmtuar forcat gjermane në tërheqje, me qëllim që ato të mos shkonin të organizuara në Frontin Perëndimor kundër Aleatëve. Në këtë aspekt është e njohur lufta e dy divizioneve tona në ish Jugosllavi për të ndihmuar në çlirimin e popujve jugosllavë, divizione këto që vazhduan të pengonin e dëmtonin forcat gjermane që tërhiqeshin për në Frontin e Perëndimit, duke dhënë kontributin tonë në kuadrin e koalicionit botëror antifashist.

**Kryetar i OBVL, gjeneral-lejtënant (në pension), Hero i Popullit*

PERKUJTOJME, USHTARAKUN DHE VETERANIN SHEMBULLOR

Pesë vjet pa Mehmet Ukshin Gjongecin

Tek bisedojmë këto ditë ndërmjet shokësh, e kujtojmë Mehmet Gjongecin si njeriun e cilësive e virtyteve të larta të malësorit tonë trim e të ndershem. Ai ishte modeli i njeriut e kuadrit punëtor e të palodhur, sistematik dhe i rregullt në detyre, shumë burrëror, i fjalës e i veprës, i besës e i sinqeritetit, i guximtarit dhe gjykuesit të drejtë të qendrimeve e veprimeve, që nga veltja e tij e deri tek shokët, miqtë e qytetarët e tjerë, duke i dhënë drejtësi të vërtetës dhe reales, pa krijuar asnjë konflikt e përplasje ndërmjet njerëzve

ALI DEMUSHI*

Organizata e Bashkuar e Veteranëve të Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare (OBVL) për qytetin e Shkodrës, sëbashku me familjen përkujtojnë me nderime dhe respekt ish-ushtarakun dhe veteranin shembullor Mehmet Ukshin Gjongecin në përvjetorin e peste të ndarjes nga jeta.

Mehmeti u nda nga jeta në moshën 92-vjeçare me 13 Korrik 2008, në qytetin e Shkodrës, ku punoi e jetoi afro një gjysëm shekulli. Ai vinte nga një familje me tradita të larta patriotike - atdhetare, rrënjët e së cilës gjenden thellë në historinë shumë shekullore të mbarë trojeve tona etnike. Ishte biri i inxhinierit me diplomën e gdhendur në gur, i mjeshtrit të hapjes së kanaleve vaditëse në të gjithë zonën e veriut, që nga Tropoja në Dibër gjë që i bëri shërbim të madh çështjes tone kombetare, në gjysmen e parë të shekullit 20', i vlerësuar "Qytetar Nderi" i rrethit të Tropojës .

Vetë Mehmeti, i ushqyer me traditat e familjes dhe i shkolluar në Odat e kuvendeve të Malësisë së Gjakovës, me nxitjen, kujdesin e përkrahjen e babait të tij mundi të merrte mësimet e para në fshatin e tij Kolgecaj (sot qyteti Bajram Curri).

Në vitin 1944, urrjeshtua në brigadën e 25-të Sulmuese të Tropojës për çirimin e Shqipërisë dhe në kuadrin e kësaj brigade luftoi me guxim e trimëri për çlirimin e Kosovës nga nazifashistet që nga Ferizajt e Lipiani, Prishtina e Novipazari, Senica, Sanxhaku e Prepolja, duke përballuar vështirësitë e mëdha për veshje e ushqim. U bë

shembull i rezistencës në kushte të vështira moti e terreni si edhe në kushtet e një pasigurie nga te ashtuquajturit aleatë partizanë serbo-malazezë të Titos, të cilët ishin një thikë vdekjeprurëse pas kurrizit të partizanëve tanë e popullit shqiptar të Kosovës, çka e vërtetoi më vonë masakra e Tivarit.

Pas çlirimit të vendit Mehmeti mundi të shkollohej e të kualifikohet në kurse e shkollat tona ushtarake duke arritur që të bëhej oficer i lartë, specialist i ndërlidhjes në ushtrinë tonë. Ka mbajtur gradën e nënkolonelit në pension.

Në vitin 1953, Mehmeti mori goditjen e parë nga sistemi komunist duke u përjashtuar nga ushtria sepse në ditën e vdekjes se diktatorit sovjetik Josif Stalin u shpreh: "Unë nuk kam qarë kur më ka vdekur babai im, prandaj smund të qaj për Stalinin që nuk ma ka lindur nëna ime e që nuk e kam as ne farë e as në fis".

Për këtë qëndrim u mbajt në survejim të vazhdueshëm nga sigurimi i shtetit për vite me rradhë për të gjetur ndonjë shkak për arrestimin e tij, por me ndryshimin e politikës e marrëdhënieve me ish-B.S, mundi të rikthehej në ushtri si oficer i saj, duke shërbyer me devotshmëri, që nga Gjirokastra ne Burrel e Shkodër, derisa doli në pension.

Pasioni e shtynte të punonte për çështjen e mbrojtjes së vendit edhe pas daljes në pension, duke përgatitur telegrafistët në kuadrin e radioamatorizmit në qytetin e Shkodrës.

Mehmeti gjithashtu kontribuoi deri në fund të jetës së tij në lagjen e banimit në Shkodër për edukimin patriotik e atdhetar të rinjëve. Me shumë pasion u fliste atyre për Shqipërinë etnike, veçanërisht për

Kosovën tone kreshnike, çlirimi i së cilës ia bëri zemren mal dhe sa herë e kujtonte këtë fakt i dilnin lotë gëzimi e mallëngjimi, për çka s'kish arritur ta realizonte me shokët e tij gjatë luftës Nacionalçlirimtare, por që u arrit pas më shumë se një gjysëm shekulli në sajë të luftës heroike që bënë bijtë e bijat e Kosovës, të rrjeshtuar në UÇK-në e të ndihmuar nga NATO-ja, anëtare e së cilës u bë Shqipëria, e cila gjatë kësaj lufte i shërbeu asaj si bazë mbështetjeje ku edhe shumë bij të saj dhanë gjënë më të shtrenjtë, jetën, për çlirimin e Kosovës .

Tek bisedojmë këto ditë ndërmjet shokësh, e kujtojmë Mehmet Gjongecin si njeriun e cilësive e virtyteve të larta të malësorit tonë trim e të ndershem. Ai ishte modeli i njeriut e kuadrit punëtor e të palodhur, sistematik dhe i rregullt në detyre, shumë burrëror, i fjalës e i veprës, i besës e i sinqeritetit, i guximtarit dhe gjykuesit të drejtë të qendrimeve e veprimeve, që nga veltja e tij e deri tek shokët, miqtë e qytetarët e tjerë, duke i dhënë drejtësi të vërtetës dhe reales, pa krijuar asnjë konflikt e përplasje ndërmjet njerëzve. Pikerisht për këto cilësi ai gëzonte respekt të veçantë nga vartësi, eprorët, kolegët dhe qytetarët dhe njeherësh ishte shumë i dashur me ta .

Dy djemtë e dy vajzat e Mehmetit sot janë krenarë më shumë se kurrë tek dëgjojnë shokët, kolegët dhe miqtë e tij që flasin me respekt e dashuri për babin e tyre. Njëherësh keta shokë, kolegë e miq urojmë që trashëgimtarët e Mehmetit të punojnë pa u lodhur për të çuar më përpara traditat e familjes, proceset demokratike të cilat Mehmeti i



përqafoi dhe i mbështeti pa rezervë, për sa punoi e jetoi sepse në këtë mënyrë do të lënë vlera për brezat e ardhshëm.

Këtë shkrim u përpoqa ta realizoj edhe për një fakt tjetër, që t'u kujtojmë të rinjëve të mos harrojnë ato figura të cilat kanë lënë gjurmë për mirë në historinë e vendit e të kombit tonë, si në luftë, në punë e

në jetë sepse kanë çka të mësojnë e tu tregojnë brezave që do vijnë!.

Respekt e mirënjohje për jetën e veprën ish-kolegut tonë, ushtarakut e veteranit shembullor Mehmet Gjongeci.

I PËRJETSHËM KUJTIMI I TIJ!

*N/Kolonel në pension



Lamtumirë Llukan Todhe

Më 12 qershor iu dha lamtumira e fundit të dashurit, shokut, mikut, bashkëluftëtarit dhe bashkëpunëtorit tonë të ngushtë, Llukan Todhe.

Ai lindi më 13 shkurt 1927 në fshatin Limar të Malëshovës së Përmetit, në një familje të mesme patriotike.

Prindërit, Todhe dhe Argjiro e rritën dhe e edukuan Llukanin me ndjenja patriotike e atdhetashurie, veti që u pasqyrua me pjesëmarrjen e tij që në rininë e herëshme në

Lëvizjen Nacionalçlirimtare për çlirimin e vendit nga okupatorët e huaj. Në gjurmët e vëllait më të madh, Prirro, ai ndoqi me stoicizëm rrugën luftarake të Brigadës së Parë Sulmuese, si ish partizan i saj deri në çlirimin e plotë të vendit.

Mbas çlirimit, Llukani kreu me devotshmëri shërbimin ushtarak në Korçë, dhe më pas u transferua në qytetin e Durrësit.

Gjatë jetës së tij ai është karakterizuar nga përkushtimi ndaj familjes dhe punës.

Familja e Llukanit gëzon respekt të thellë nga qytetarët e Durrësit me të cilët ka punuar dhe jetuar deri në ditën e vdekjes.

Llukan Todhe, që nga viti 1993, sëbashku me Ernest Jakovën, Zenel Bardhin, Genc Ballancën, Ferid Vocin e të tjerë, ka qenë në drejtimin e Organizatës të Bashkuar të Veteranëve të Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare për qytetin e Durrësit. Punoi me përkushtim si sekretar organizativ i kësaj organizate. Për mer-

itat dhe kontributin e dhënë shtë dekoruar nga OBVL me titullin "Veteran Nderi".

Me vdekjen e tij, familja humbi njeriun më të dashur, fëmijët humbën babain e dhëmbshur, ne shokët humbën bashkëpunëtorin tonë të palodhur.

Respekt dhe nderim të thellë për shokun tonë Llukan Todhe.

I përjetshëm kujtimi i tij.
GENC BALLANCA
Kryetar i OBVL, Dega Durrës

Kryeministri në mbledhjen e parë të qeverisë pas zgjedhjeve të 23 qershorit: Gazsjellësi TAP, arritja më e madhe strategjike pas anëtarësimit në NATO

Qeveria dhe administrata të përkushtuara deri në betimin e kabinetit të ri

Në mbledhjen e parë të qeverisë pas humbjeve në zgjedhjet e 23 qershorit kryeministri Sali Berisha vlerësoi miratimin e projektit të gazsjellësit TAP si një burim kryesor energjetik për shqiptarët. Per kreun e ekzekutivit ky projekt është arritja më e madhe strategjike e Shqipërisë pas anëtarësimit në NATO, i cili do t'i japë zgjidhje përfundimtare energjisë dhe do të krijojë edhe mijëra vende pune.

"Ky është projekti më i madh i gazit në Evropë. Investimi prej 40 miliardë dollarë tejkalon cdo projekt tjetër gazsjellësi. Do krijojë vende pune. TAP përbën arritjen më të madhe të Shqipërisë pas anëtarësimit në NATO në fushën strategjike"- theksoi kryeministri Berisha. Ai gjithashtu i ka shprehur mirënjohje qeverisë së Azërbajxhanit, e cila ka dëshmuar ndjenjat më miqësore ndaj shqiptarëve

dhe Shqipërisë si edhe ka vlerësuar konsorciumin Shah Deniz 2. Më tej ai iu drejtua ministrave dhe administratës në veçanti, që ato të punojë me përkushtim deri në ditën e fundit të dorëzimit të pushtetit, fituesve të zgjedhjeve të 23 qershorit. Pas certifikimit të rezultatit të zgjedhjeve Kryeministri Berisha ka dhënë dorëheqjen nga të gjitha funksionet në Partinë Demokratike.



Zgjedhjet, shqiptarët kanë arsye të jenë krenarë

(vijon nga fq 1)

Mëtutje, zoti Engel i ka uruar Edi Ramës dhe koalicionit socialist në fitoren e tyre, duke theksuar se pret të punoj me qeverinë e ardhshme. "Liderët politikë të Shqipërisë dhe populli, kabineti i ardhshëm i ministrave dhe anëtarët opozitarë nga i gjithë spektri politik, duhet ta dinë se Kongresi i Shteteve të Bashkuara qëndror krahas për krahas me Shqipërinë", tha Engel, dhe shtoi se me këto zgjedhje, Shqipëria ka dërguar "mesazh të qartë të Bashkimit Evropian se është e gatshme për status të kandidatit" dhe se marshi i shqiptarëve kah anëtarësimi në BE vazhdon. Kongresmeni Eliot Engel, e ka falënderuar edhe kryeministrin Sali Berisha për shërbimin e tij për këtë vend.

"Shqipëria ka bërë hapa të mëdhenj përpara derisa ai ishte në këtë post, përfshirë anëtarësimin në NATO", tha Engel, duke i uruar atij çdo gjë të mirë në të ardhmen. Zoti Engel, që është bashkëkryesues i grupit për çështjet shqiptare, thotë se shqiptarët mund të llogarisin në mbështetjen e tij në rrugën e tyre historike, pasi pak vende në botë kanë lëvizur aq shpejtë si Shqipëria nga "jodinjiteti i sistemit totalitar në dinjitetin dhe premtimet e dekokracisë së pjekur".

Në fund të deklaratës së tij, ai thekson se të gjithë shqiptarët kanë arsye të shumta sot për të qenë krenarë.

Fyle dhe Ashton vlerësojnë zgjedhjet e lira dhe procesin e rregullt zgjedhor

Në një deklaratë, përfaqësuesja e lartë Catherine Ashton si dhe komisionerit Stefan Fyle përgëzuan qytetarët shqiptarë për zgjedhjet e lira dhe procesin e rregullt zgjedhor në këto zgjedhje parlamentare në Shqipëri. Ata kritikuan rastet e raportuara të ushtrimit të dhunës dhe incidentet e ndodhura në këto dite, duke apeluar që të iniciohen hetime në mënyrë që autorët përgjegjës të përgjigjen para drejtësisë.

Ata e cilësuan të rëndësishme që pjesa e mbetur e këtij procesi zgjedhor të bëhet në përputhshmëri me standardet ndërkombëtare dhe ato të BE-së.

Fyle dhe Ashton rekomanduan në formë këshille për subjektet politike në Shqipëri për frymë konstruktive dhe inkurajuan formimin e menjëherëshëm të qeverisë pas certifikimit të rezultateve.



Shqiptarët e Çamërisë do të kenë zërin më të fuqishëm në mbrojtje të tyre

Shqiptarët e Çamërisë dhe të çdo treve tjetër të kombit, më 27 qershor përkujtuan me nderim kujtimin e më shumë se 5 mijë shqiptarëve të vrarë në pabesi nga forcat zerviste në fund të Luftës së Dytë Botërore. 27 qershori, dita e nisjes së genocidit ndaj shqiptarëve të Çamërisë, me masakrën e Paramithisë, do të mbetet gjithnjë data e përlules ndaj kujtimit të të parëve dhe burimi i forcës për çuarjen përpara të çështjes çame, pjesës më të paprekur të çështjes sonë kombëtare.

"Sot, 69 vjet më vonë, ne e plotësuam amanetin e të parëve. Varrezat Monumentale të Shqiptarëve të Çamërisë në Qaf-Botë, të inaguruara pak ditë më parë, janë përlujta më e mirë që ne, pasardhësit e shqiptarëve të Çamërisë, shoqata "Çamëria" dhe PDIU mund t'ju bënim kujtimin të tyre. Kapitulli i së kaluarës është mbyllur, tashmë ne

shohim ballëllartë të ardhmen, me besimin dhe përkushtimin e plotë për zgjidhjen përfundimtare të çështjes çame", -thuhet në një deklaratë për shtyp të PDIU.

Në këtë 69 vjetor, shqiptarët e Çamërisë do të kenë zërin më të fuqishëm në mbrojtje të tyre, do të kenë pesë djem të Çamërisë në Kuvendin e Shqipërisë, që do të qëndrojnë për katër vjet në këmbë në mbrojtje të kauzave tona të shenjta. Çështja çame dhe çështja kombëtare, sot do të jenë më të përfaqësuara se kurrë më parë, për shkak të besimit që 50 mijë shqiptarë i dhanë forcës sonë, forcës së programit, forcës së kauzave, forcës së alternativës kombëtare.

Por, në këtë 69 vjetor, kauzat tona dhe deputetët që kanë barrën e rëndë që t'i mbrojnë ato, nuk mund të hyjnë në asnjë pazar politik. Sepse, PDIU nuk bën pazar politik me kauzat, por i qëndron besnike amanetit të të



parëve dhe besimit të shqiptarëve për të ngritur zërin ndaj çdo padrejtësie që i bëhet kombit tonë, për të mbrojtur çdo shqiptar nga Preveza në Mitrovicë e deri në Mollën e Kuqe.

Shqiptarët i kthyen dinjitetin Shqipërisë, duke rritur zërin kombëtar, zërin e Çamërisë në parlamentin sh-

qiptar. Qytetarët i kthyen borxhin 5000 shqiptarëve të Çamërisë që humbën jetën vetëm dhe vetëm pse ishin shqiptarë, si sot, 69 vjet më parë. Tani është momenti që kauzat tona, që jenë kauzat e mbarë kombit shqiptar të gjejnë zgjidhjen e merituar.

Kulturë

U BOTUA LIBRI I SHUMEPRITUR "POETI I MALESISE"

"Artisti i Merituar" Prendush Gega - poeti i Kabashit

RAPSODI I SHQUAR PRENDUSH GEGA - "Artist i Merituar", (Bicaj, Kabash, 22gusht 1850 - 20 shkurt 1938)



Nga Xhemal MEÇI, studiues "Mjeshtër i Madh"

MJEDISI HISTORIK I Vendlindjes

Prendushi u lind më 2 gusht 1850 në fshatin Bicaj, dikur lagje e Kabashit. I ati quhej Gegë Paloka. E ëma, Lenë, bi prej Qerretit të Vogël. Edhe e shoqja quhej Lenë. Kanë pasë një vajzë, martuar në Fierzë.

E ëma, Lena, kur erdh, vazhdoi të përgatiste çerepë prej argjili, që përdorshin për pjekjen e bukës. Dikur, para mesit të shek. XX çerepi kishte përdorim të gjerë prej barinjëve në kollota e buna (stane), si edhe në fshatra, kohë pasigurie, në udhëtime karvanesh etj. Kjo zeje ishte traditë te prindërit e Lenës. Kështu u bë traditë edhe te Djegajt, siç quheshin pasardhësit e Gegë Palokës, sepse toka e Djegajve ishte e pasur me argjil cilësor dhe kishte mjaft kërkesa për çerepë të atij argjili.

Kabashi (Puka), një vendbanim historik me rëndësi politike, ekonomike dhe kulturore deri në fillimet e shek. XVIII, sidomos para sundimit osman. Deri në fillimet e mijëvjeçarit të parë Kabashi quhej Pukë, kurse me fuqizimin e Abacisë së Shën Palit, filloi të quhej Shpal. Ndërsa me ardhësit prej Jugut të Gjini Kabashit, qefali, që u vendosën rreth Kodrës së Kuvendit, qendra e Kabashit, Shpali filloi të quhej sot e asaj dite Kabash.

Përmasa Kabashit, që në lashtësi, kur quhej Pukë, kalonte udha e karvaneve që lidhte Bregdetin e Shkodrën me Kosovën e Maqedonin Veriore e më përtej, që solli një lulzim ekonomik, kulturor e politik me qendër urbane, kështjellë dhe një rrjetë kishash. Këtë e pohojnë edhe relatorët e shek. XVII. Frang Bardhi shprehet në relac. e vitit 1637: "Kabashët e shën Palit ... në të kaluemen ishin shumë të pasun." Edhe Shtjefen Gaspri më 1671 shënon faktin se "Puka (Kabashi) ishte qytet i famshëm dhe i ndritur." Po kështu, është ruajtur gojdhana se "Kabashi ishte një gjytet pergjatë Gomines: Qaf-Ajtyr' e Qafë-Rrgjane (me një shtrirje hiperbolike afro 5 km gjatësi) aq sa macja kalonte çati mbi çati pa pasë nevojë të ecte për tokë." Kurse, "Në Fushblinisht, vazhdon gojdhana, - Lekë Dukagjini kishte sarajet, "Sarajet e Leks", ku kalonte një pjesë të kohës. Afër Sarajeve ishte "Guri Filxhanash", ku u nxirte kafe udhëtarëve. Pak më posht ishte "Kroni Lekë Dukagjinit", një burim uji shumë i mirë." etj.

Familjet fisnike Ziu dhe Blinishti. Në këto kushte zhvillimi, që nga fundi i mijëvjeçarit të parë, u formuan familjet fisnike: Ziu dhe Blinishti. Këto familje, si u fuqizuan, kërkuan hapë-

sira të reja jetike e politike, prandaj u shtrinë deri në brigjet e Drinit të Zi (Malzi), në Mirditë e Zadrimë me Shëngjin, Rragam e Sarda (Shurdhah). Fuqizimi i këtyre familjeve fisnike përcaktoi edhe modën e grave të tyre, që në vazhdim u shtri mbi gjithë fshatrat e brigjeve të Gominës me emrin e Pukës: "Vesh Pukore", një veshje e bukur me qendisje ari e argjendi, "jelek arit". Në këtë traditë u përgatitë më vonë edhe "Vesha Kabashit" ("Vesh me kanac rrotull" e grave myslimane) një veshë ngjyrëkuqe, me qindisma ari e argjendi, që shpreh bukuri, krenari, hare, gjallëri, optimizëm, dinjitet.

Në këtë epërsi zhvillimi dhe arrijesh kryesisht në Pukë (Shpal, Kabash), e ka zanafillën edhe pozita e fisit dhe të bajrakut të Kabashit: "Fis e bajrak i parë në Shtatë fiset dhe Shtatë Bajrakët e Pukës, si edhe i treti në 12 fiset e Veriut, Fiset e Leks" (Lekë Dukagjinit)."

MJEDISI ARTISTIK I KABASHIT DHE I PUKËS

Krijimtaria artistike popullore. Krahas modës, ka pasë zhvillim edhe krijimtaria artistike popullore: kënga e melodia "kajde kabashi". Kjo jetë e pasur artistike i ka tërhequr vemendjen edhe F. Bardhit, sa e shënon edhe në një relacim me karakter fetar (Relac. 1637...): "Kanë shumë zakone fisnike dhe kështu, sipas zakonit të të moçemve, nder gostitjet e veta, në rrugë e në punë, këndojnë (kajken perpjete) me za të naltë trimënitë e burrave të tyre të mëdhaj, dhe sidomos të pathyeshmit z. Gjergj Kastriotit, të thanunit Skandërbeg, dhe të përndritshmit zot Lekë Dukagjinit, princit dhe zotnisë së tyre."

Tradita e "kajkes perpjete" ishte aq e rrënjësor, sa para 80 vjetësh, mbahen mend dy këngëtarë prej Kabashi, lagje Meçe: Hamëz Ademi e Ramadan Kopani. Ata edhe gjatë kullotjes së bagëve në mal, kur fillonte këngën e kushtrimit "përpjete" njëri, ia ndiqte tjetri në shtatin e malit përmbri me za aq melodioz, sa habisnin edhe gëzozin kalimtarët në udhëtim e sipër, aq mirë këndonin edhe pse shpateve të maleve. "Kangen perpjete" ka pasë raste që e këndonin edhe femrat si: Prenda e Frane Nikë Deda, bija Qelze. Këto ia ndiqnin aq mirë njëra-tjetrës "kangen perpjete" në "kajde Kabashi", sa kujtohen edhe sot me simpati. "Njëkohësisht janë kënduar në nivel artistik vaje grash e gjamë burrash deri nga mesi i shek. XX. Gjergj Fishta, kur ishte famullitar në Gomsiqe, në mortin e një burri në zë, u mrekullua prej vajit të një gruaje të varfër prej Puke. Ndër të tjera shënon këto vargje: "Kur erdh vakti per me dal, / o miku jem! / Plasi kulla ball per ball, / o miku jem! / U lshu dera per me t'ndal, / o miku jem! / Po fjala zotit s'kthehet dal, / o miku jem! / Fishta këto vargje i merr si hyjnor, prandaj u shpreh me entuziazem: "Kësaj vajtorje lypsare (të varfër) prej Puke do t'ia kishin zili edhe poetët e lashtë helenë e romakë."

Tradita artistike "sipas zakonit të të moçemve" ka vazhduar në Pukë (Kabash) brez pas brezi. Kulmoren e ka arritë me Prendush Gegën. Bashkohësit e Prendushit tregonin se edhe i ati, Gega, (Djega) ka krijuar bejte dhe, ndoshta, edhe këngë historike, por nuk janë ruajtur sepse ishte krijimtaria e shumtë, e gjallë, e fuqishme dhe me



realizim të lartë artistik, e Prendush Gegës që mbizotëroi çdo krijimtari rapsodike para e gjatë shekullit të tij. Kështu ne kemi arritë vetëm deri te Shekulli i "Poetit të Kabashit". Në përhapjen dhe ruajtjen e këngëve të P. Gegës ka ndihmuar këndimi i tyre prej vetë P. Gegës, si në gosta, festa, dasma, raste tubimesh, gjatë prashitjeve, por edhe gjatë Panairit Pranveror të Kabashit; panairi i përvitshëm, një javë para Pashkëve, "Diten e Larit", që shoqërohej me shkëmbime të ndryshme tregtare, i shoqëruar me veprimtari artistike, me këngët e Prendushit, fyje, zamare, lahuta e çifteli, sidomos këngë me lahutë, të cilat sa që gjallë i krijonte dhe i këndonte vetë, si edhe "kangen perpjete" shoqëruar me Matosh Ndreun, Man Idriz Haxhën etj.

Nga fundi i Shekullit të P. Gegës kishte "shpi e lahut". Një fakt të tillë e ka pasqyruar të përgjithësuar në shkrimet e tij edhe profesori i shquar Ernest Koliqi më 1942: "Dhe tashti të vijmë tek tipi i tretë i këngëtarit, te poeti që krijoi kangëtorën e vet, që nuk këndon tjetër veçse këngët e krijimtarisë së tij. Në Kabash të Pukës jetonte deri para pak vjetësh poeti i malësisë, Prendush Gega, i permendun që prej fushoreve të Kosovës deri në brigjet e Adriatikut." Është me interes të theksohet fakti se si prof. Ernest Koliqi arriti në përfundimin se P. Gega "krijoi kangëtorën e vet" që mori tiparet e një shkolle artistike. Kjo "kangëtoare" artistike do të shërbejë për më se një shekull si shkollë model për këngëtarët e rapsodët e vazhdimësisë, si: Pal Nika në Qelzë, Tomë Nikolla në Iballe, Frrok Haxhia në Spaç Fran Pali, Vitor Shahini etj. Studiuesi Bardhosh Gage

shënon faktin se "Një ndikim të madh në krijimtarinë poetike të Frrok Haxhisë ka dhënë edhe krijimtaria e rapsodit popullor të Kabashit të Pukës, Prendush Gega, "Artist i Merituar".

Kënga, tematika, arti. P. Gega për mëse 50 vjet që prej viteve të vrullshme të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit dhe deri nga fundi i viteve '30 të shek. XX krijoi rreth 100 këngë e bejte me vlera të shumta ideoartistike me shtrirje në mbarë Shqipërinë Veriore, "që prej fushoreve të Kosovës deri në brigjet e Adriatikut". Tematika e këtyre këngëve është e shumëllojshme, sidomos me motive patriotike, shoqërore e morale tradicionale me rol të gjithanshëm edukativ, optimist e frymëzues për një malësor të vrytytshëm. Ngjarjet historike të kohës u bënë kronika artistike emocionale që shprehin interesa kombëtare, shoqërore e morale. Kështu tematika e këtyre këngëve përfshinë Lidhjen Shqiptare të Prizrenit me personazhet: Rustë Kabashi, Mic Sokoli, Sulejman Vokshi, Mustafë Agë Kryeziu, Rexhep Agë Malziu, Zeqë Demë Kabashi etj. Kryengritjet për Liri e Pavarësi që me Kaçanikun, Mirditën e Pukën deri te kryengritës e udhëheqës çetash, si: Ndoc Mark Deda, Mark Koliqi, Ndue Mark Prendushi, Marash Marku, Frrok Kolë Gjonit, Prend Zeqë Kabashi, Nikollë Curri, Ndocë Qafa, krenë e bajraktarë me Zenel Agen, Halil Musen, Kolë Mark Vata.

"Nat Stamboll po kndon gazeta: / Qarti paqen Ndoc Mar Deda / S'i nep armt sa t' jet jeta! / - Sa t'jet jeta armt s'i nap!"

Tema e luftës me pushtuesit serbë ze një vend me rëndësi në krijimtarinë

e P. Gegës, ku sulmohen barbarizmat e pushtuesve serbë dhe lartësohen malësorët luftëtarë trima në veçanti, si: Ismail Arifi, Sadik Hoxha, Osman Hoxha, Bajram Haziri etj. Njëkohësisht vlerëson edhe heroizmin në tërësi të Shkodrës, gjatë rrethimit barbar serbomalazez 1912-'13. Po kështu vlerëson Fletin, Lajthizën e Malziut që i shkaktuan shumë humbje dhe e gozhduan për tri ditë divizionin ushtarak serb "DRINA".

"Dalin Shkodra si asllana! / ... Top e pushk, Shkodra shkret! /

Per Shqipni po don me dek! / ...

"Qesi djemsh na i ka Fjeti! / S'i ka Krajli, s'i ka Mbreti, /

S'i mban toka, s'i mban deti! / ... Kan nis luften me Serbi! /

Gjasht taborre kan mbet prej 'i ditë / Dy mij vet kan dal komit! / ...

Kryengritja e Nikollë Currit kundër sundimit austrohungarez pasqyrohet në disa këngë në formë kronikash, ku jepen me mjete të goditura artistike skena historike me luftime heroike, ku Nikollë Curri me çetën e tij del i paepur, drangua, fitimtar. Edhe kundërshtimi i armatosur deri në vdekje i Sali Tahirit del burrëror, heroik, me mesazhin se armikut i duhet qëndruar ballas. Gjithashtu, jehona e qëndresës së gruas, femrës, me armë e vlerëson aq sa i jep përmasa deri në kryeqytete mbretërishe e shtetesh, si: Laje Rexhep Agës, Zojë Mustafës, Kune Preles, Preçe Kocës etj. Trimëritë e tyre i dëgjoka Europa, sa:

"Krajli Itales ban pleqni: / Seri baj per ket Shqipni, / ...

Qesin grat me pushk per sy, / Si askeri talimxhi! / (talimxhi: i stërvitur).

"Kune Prelja, bi Merturi! / ... Po qet pushk si Nikoll Curri!"

Personazhet i lidh gjithnjë me vrytyte burrërore: me trimërinë e guximin, me besën e bujarinë, me urtinë e thjeshtësinë. Personazhet e rapsodive të tia janë real, të ditës me trimëri, guxim e bëma në përmasa kreshnikësh, zanash e dragojsh, me jehonë në "shtatë krajlit" deri në tërë Europën. Kundër atyre, që kanë pabesinë e hjekësinë, dhunën e cubninë, mangësinë e krenarinë boshe, ngatërresën e lakminë i sulmon e i thumbon, i përqesh e i fshikullon. Me këto mjete artistike të P. Gegës ishte njohë edhe Migjeni për të cilin thotë se "asht i humorit, ka një ironi të përsosun që të ven në lojë pa e kuptue."

Arti në krijimtarinë e P. Gegës, "Poeti i Kabashit", sidomos te këngët historike, ka lidhësi të plotë me vazhdimësinë e ngjarjes, por pa rënë në hollësira të ndodhive. Kështu mjanon zgjatjen e panevojshme dhe i jep vargut dinamizmin e ritmin e duhur për të shpreh thelbësoren. Vargjet janë krejt të natyrshe, krijuar me frymëzim dhe emocione të forta, ku idetë dhe përmbajtja shprehen me fjalor të pasur e të gjetur, me mjete të gjalla poetike e ritmike. Prendush Gega është rapsodi që ka përdor me aq mjeshtri mjetet artistike, si: monologun e dialogun, epitetin e metaforën, hiperbolën dhe evokimin, krahasimin dhe apostrofen, personifikimin e persëritjen, inversionin dhe onomatonë, automazinë dhe antoniminë, koloritin lokal dhe asindetin, elegjinë dhe pyetjen retorike, ironinë e sarkazmën etj. P.sh. :

"Don me vra ket beg te rand, / Don me vra qat Mustaf Agen! / ...



Promovohet libri me kujtime i ish-Sekretarit amerikan të Mbrojtjes

Rumsfeld: I lumtur për botimin në shqip

Shhtëpia Botuese "55" promovoi para disa ditësh në mjediset e Hotel "Tirana", librin me kujtime të ish-Sekretarit amerikan të Mbrojtjes, Donald Rumsfeld. Në ceremoni morën pjesë ministrat Mediu, Kosova e Zhiti, si dhe kryebashkiaku i kryeqytetit, Lulzim Basha. Në çelje të ceremonisë, botuesi Balliu shprehu krenarinë e tij, për suksesin që kishte njohur tek lexuesit e të gjithë hapësirës shqiptare libri me kujtime "Të njohura e të Panjohura".

Më pas, kreu i Bashkisë së Tiranës, Lulzim Basha, ka nderuar me titullin "Mirënjohja e Tiranës", ish-Sekretarin e Mbrojtjes, Donald Rumsfeld: "Me mirënjohje për kontributin e tij të shquar, në forcimin e lidhjeve mes Shqipërisë dhe SHBA. Ky titull është një tregues i mirënjohjes për rolin e tij të veçantë në anëtarësimin e Shqipërisë në Aleancën e Atlantikut të Veriut dhe një demonstrim i respektit të thellë që i akordon qyteti i Tiranës për vitet e tij të shërbimit në SHBA dhe mbarë botën", thuhet në motivacionin e mirënjohjes së Bashkisë së Tiranës. Ish-ministri i Jashtëm i Shqipërisë, Lulzim Basha, i ka shprehur ish-Sekretarit amerikan të Mbrojtjes, Donald Rumsfeld, mirënjohjen e thellë të çdo shqiptari për kontributin e tij në anëtarësimin e Shqipërisë në NATO. "Kthimi juaj në Tiranë është padyshim një lajm shumë i gëzueshëm për të gjithë shqiptarët që vlerësojnë miqësinë tuaj, të demonstruar me vepra dhe me punë, për të arritur një ndër destinacionet më të rëndësishme të vendit tonë, anëtarësimin e Shqipërisë

në Aleancën e Atlantikut të Veriut në NATO. Në këtë stacion të rëndësishëm, ne arritëm për shkak të reformave dhe punës sonë, por vetëm përmes mbështetjes së gjithanshme të SHBA dhe në veçanti Presidentit George W Bush dhe tuajën personale, në kapacitetin e Sekretarit të Mbrojtjes të SHBA", u shpreh Basha. Kryebashkiaku Basha e ka konsideruar frymëzim të madh për brezat e rinj, pasionin dhe forcën me të cilën Donald Rumsfeld kreu misionin e tij historik, në raport me lirinë e njeriut, si vlera themelore për përparimin e çdo shoqërie. "Jeta juaj është një burim frymëzimi për të gjithë personat në shërbim publik, por po kështu është një burim frymëzimi për çdo të ri dhe të re, në duart e së cilit do të vijë ky libër. Ju i përkisni një brezi, të cilët mbajtën premtimin e një bote të lirë nga frika dhe terrori përballë shumë kërcënimeve, kërcënimeve të nazizmit, të totalitarizmit komunist dhe të pasigurisë globale që synoi të krijonte terrorizmi në botën e pas Luftës së Ftohtë", theksoi zoti Basha.

Në përshëndetjen e tij, ish-ministri i Mbrojtjes, Fatmir Mediu (sot ministër i Bujqësisë, në kabinetin "Berisha"), falenderoi zotin Rumsfeld, sepse ka qenë një nga miqtë më të veçantë të shqiptarëve, i cili "na ka mbështetur në të gjitha reformat, jo vetëm thjesht forcat e armatosura, por edhe institucionet e sigurisë, për reformat e rëndësishme për të anëtarësuar Shqipërinë në NATO", tha ish-ministri i Mbrojtjes, Mediu. Atëhere kur shumë pak besonin në këtë proces, vijoi zoti Mediu, ai na mbështeti,

atëherë kur shumë njerëz ishin skeptikë, ku kishte edhe nga ata njerëz që padyshim ishin kundër këtij procesi, unë dua ta falenderoj sinqerisht për gjithë kontributin që ai ka dhënë, për të pasur një siguri në botë, por në mënyrë të veçantë për mbështetjen e Shqipërisë për të marrë ftesën për anëtarësimin në NATO. Libri me kujtime i Donald Rumsfeld është një libër, të cilin do tua këshilloja të gjithëve ta lexonte, theksoi zoti Mediu, jo thjesht për të parë historinë e një njeriu, i cili ka kaluar pjesën më të madhe të tij për t'i shërbyer vendit të tij, por për të parë figurën dhe autoritetin e një shtegtari të vërtetë, i cili nuk u ndal asnjëherë përballë opinionit, për të bërë atë që besonte se ishte më e mira për vendin e tij pa asnjë kompromis, por për të luftuar gjithmonë për të drejtën dhe njëkohësisht për të krijuar mundësinë që lirinë ta gëzojnë jo vetëm amerikanët, por sa më shumë vende në mbarë botën".

Një përshëndetje në ceremoni ka bërë edhe ministri i Kulturës, zoti Visar Zhiti, i cili shprehu mirënjohjen si qytetar dhe si ministër, për gjithçka të madhe dhe të rëndësishme që SHBA kanë bërë për vendin tonë.

Sekretari i Pentagonit, Donald Rumsfeld, është shfaqur i emocionuar gjatë ceremonisë, duke shprehur kënaqësinë e tij të veçantë, që kujtimet e tij ishin botuar edhe në gjuhën shqipe. "Jam shumë i lumtur që ndodhem në këtë vend shumë të bukur, tha zoti Rumsfeld. Ky është një privilegj i madh për mua. Falenderoj zotin Balliu, kjo është një mikpritje e shkëlqyer. Kam menduar se isha shumë



i ri për të shkruar një libër, nisi rrëfimin e tij të sinqertë për të pranishmit, ish-shëf i Pentagonit, por kur vajta tek të 70-at, kuptova që nuk isha më shumë i ri. M'u deshën katër vite për të shkruar këtë libër, pasi kërkon te kohë për të mbledhur dokumente, arkiva dhe artikuj. Çdo njeri ka një këndvështrim të ndryshëm për historinë, por në librin tim kam shmanjur subjektivizmin dhe jam bazuar në dokumentacion. U ndjeva jashtëzakonisht i lumtur, kur mësova se libri u botua në Shqipëri. Ka një miqësi të veçantë mes Shqipërisë dhe SHBA-së". Gjatë vizitës sime kam dëgjuar fjalët më të këndshme për vendin tim. Por, duhet të shikojmë edhe anën tjetër, atë çka Shqipëria dhe qeveria shqiptare i ka sjellë Perëndimit. Në një konferencë për shtyp, përmenda frazën Europë e Vjetër dhe hasa kritika për këtë frazë. Kur isha ambasador i SHBA-së në NATO, ishim 15 vende anëtare, ndërsa tani jemi 28 dhe qendra e gravitetit është lëvizur drejt Lindjes dhe sot

shohim një Europë të ndryshme nga ajo e Shekullit XX. Shumë vite më parë, kur isha shëf i personelit të Fordit, mbaja shënime në një bllok të vogël. Fordi më tha se dëshironte që t'i shihte këto shënime dhe kur i lexoi, i pagëzoi "Rregullat e Rumsfeldit" dhe porositi administratën që të vepronte sipas tyre. Kështu, para një viti shkrova një libër, "Rregullat e Rumsfeldit", pasi siç thonë, rrëfimi është i mirë për shpirtin. Por ato nuk janë vetëm rregulla të Rumsfeldit, por edhe të personaliteteve të shquara si Çerçilli, etj. Nuk janë vetëm rregulla, por edhe ide. Një kopje të këtij libri po ia dorëzoj botuesit tim Fahri Balliu për ta botuar, duke i shprehur edhe njëherë falënderimet e mia për botimin e librit të parë "Të Njohura dhe të Panjohura".

Në fund, në një mjedis që u shndërrua në një forum ku shkëmbeu pikëpamje për çështjet e sigurisë dhe rolin që po luajnë shqiptarët në NATO, Donald Rumsfeld firmosi dhjetëra autografe për të pranishmit.



Se ktu i thon Puk' e Mirdit: / Kan zanatin pushk me qit...

S'ka ça m'ban alltia mue / Se m' ka ba lokja drangue."

(1. NIMASBAT POE SHKRUE KADIA, ku, siç shihet, përdor njëkohësisht edhe: përsëritjen + metaforën + evokimin + personifikimin + antomazinë etj.).

"Ku po shkon maxhyp i zi?! / Maxhyp i zi kah je tuj shkue?!"

(5. Të vargjet : KTO BIDATE NUK T' I DUE përdor njëherit: pyetjen retorike + metaforën + sarkazmen + epitetin dhe inversionin.) Po kështu të kënga " 10. AI GJIN LEKA PELIVANI": "Dridhet shehri prej trishtimit, /

Nam po ban alltia Gjinit: / N'od t' Valis, n'at od t' meshinit!": (hiperbolë + apostrophe + antomazinë + koloritin (ngjyrimin) lokal, asinetin etj.) Një prej këngëve të forta epike, me mjete artistike mjaft të gjetura është edhe kënga: 11. ZEK JAKINI FORT GAJRETI:

"Krisi pushka, ushtoi deti, / Se n'at Trush u ba gazepi!"

Zek Jakini fort gajreti; / Fort gajreti e sa mir qiti! (metonomi + personifikim + anomatope + hiperbolë + asinet + inversion etj.)

Kështu mund të vazhdojmë me plot shembuj të tjerë me këngët kushuar: Ismail Arifit, Osman Hoxhës, Nikollë Currit, Sali Tahirit, Laje e Tahir Rexhep Agës etj. por ajo që duhet theksuar është fakti se P. Gega, si edhe

rapsodë të tjerë të traditës, para e mbas tij, i zotëronin mjetet artistike me aq mjeshtri, sa mund të krahasohen me poet të shquar, sado që ishin të paarsimuar. Ky nivel i lartë artistik kishte për bazë një traditë që u përcillej brezave prej thellësisë së shekujve, siç na e dëshmon F. Bardhi në shek. XVII: "sipas zakonisht të moçemve, ndër gostitjet e veta, në rrugë e në punë këndojnë me za të naltë trimënitë e burrave të tyne të mëdhaj..."

Në përfundim, duhet theksuar se, P. Gega, gjatë krijimtarisë së tij për më se 50-vjeçare, të shekullit të tij, e pasuroi traditën e krijimtarisë artistike popullore: me një tematikë historike e shoqërore të shtuar të kohës së tij, me ngjarje e personazhe plot forcë, dinamikë, seriozë, luftarakë, heroikë, burrërorë, atdhetarë, që shkëlqejnë mbi të pabesët, dhunuesit e cubat, po edhe mburracakët, përtacët e ngatërrestarët. Gjithë ngjarjet e personazhet ndërtohen me mjete artistike me një përsosmëri, që, siç shprehej Migjeni, të përmasave me " poezitë ma të mira të poetëve tanë ma të mirë."

Njëkohësisht, këngët e tij shoqëroreshin kryesisht me lahutë e cila në duart e këtij rapsodi, siç shprehet S. Nushi, në krijimtarinë e tij "muzikore ariti të mishërojë tiparet karakteristike popullore...në variante e forma të reja, si në ripërtitjen e mëtejshme të këngës së kushtrimit dhe në rapsoditë e krijuara prej tij." Prandaj, gjatë shekullit të tij, ai mundi të krijonte "këngëtoren e vet", siç ariti në përfundimet e tij E. Koliqi. Si i tillë, nënvizon edhe G. Karma: "... ka mbetë i pavdekshëm në

gojë të popullit ndër male."

SI PËRFUNDIM

Autor i më se 100 këngëve historike, shoqërore dhe humoristike, si edhe i shumë eseve me vlera humorit e satirash për më se 50 vjet krijimtari. Këngët e tija me tematikë historike që prej Lidhjes Shqiptare të Prizrenit, Lufta për Liri e Pavarësi, Lufta kundër pushtuesve serbomalazezë e tjerë deri më 1920, bashkë me këngë për Bajram Beg Currin si edhe këngët e kundërshtimit të taksave të pazakonta, pasojat e Kryengritjes 1926 deri te këngë për Mbretin Zogu I; të cilat në tërësi u bënë model, shembull, "këngëtore" (shkollë rapsodie) për rapsodët pasardhës. Kanë mbetë këngë lapidar këngët për Rrethimin e Shkodrës, Lufta e Fletit; këngë për Gjin Lekën, Zekë Jakinin, Mustafë Agë

Kryeziun, Ndoc Mar'Dedën, Sali Kabashin, Nikollë Currin etj.

Kjo krijimtari e rrallë është kënduar që prej rrafshit të Dukagjinit, Kosovë, deri në Brigjet e Adriatikut, si edhe në festivale kombëtare. Emigrantët i kanë kënduar edhe në Europën Veriore e Përendimore deri në SHBA (USA).

GEER

Studiues dhe profesorë të shquar e kanë quajtur:

* POETI I KABASHIT, (L. Shantoja, 1921);

* HISTORIE GJALLË (Migjeni, 1936);

* POETI I MALËSISË, (Prof. E. Koliqi, 1942);

* NJË RAPSODI I MADH (Prof. Z. Sako, 1971);

* POETI I POPULLOR I KABASHIT (Prof. J. Kastrioti, 1982);

* FIGURË EMBLEMATIKE

(Prof. A. Xhagolli, 2010).

* Në Këngët e rapsodit P. Gega, sikur ligjeron e tërë Shqipëria, (Artisti i Merituar) Frrok Haxhia, 1995.

Xhemal MEÇI, studiues



Kosova shpalli pavarësinë e saj nga Serbia më 17 shkurt të vitit 2008 dhe tashmë njëqind vende e kanë njohur atë

Egjipti njeh Kosovën!

Qeveria e Republikës së Egjiptit ka vendosur për njohjen e Kosovës, shtet të pavarur dhe sovran. Vendimi zyrtar i njohjes së Kosovës nga Egjipti i është komunikuar ministrit të Punëve të Jashtme të Republikës së Kosovës, Enver Hoxhaj, nga ndihmëspresidenti i Egjiptit për Marrëdhënie me Jashtë dhe Bashkëpunim Ndërkombëtar, Essam Al-Haddad si dhe zëvendësministri i Punëve të Jashtme i Egjiptit, Seif El-Nasr, sapo bëri të ditur MPJ kosovare. Në njoftim theksohet se, vendimi i qeverisë së Republikës së Egjiptit për njohjen e Kosovës si shtet të pavarur e sovran është publikuar edhe në web faqen zyrtare të Ministrisë së Punëve të Jashtme të Egjiptit.

"Në kuadër të përpjekjeve të përhershme të Republikës arabe të

Egjiptit për konsolidimin e paqes dhe sigurisë ndërkombëtare, dhe në kuadër të asaj që thekson Karta e Kombeve të Bashkuara për të drejtën e popujve për vetëvendosje, dhe në përputhje me opinionin këshillëdhënës të Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë të nxjerrë më 22 korrik 2010, që e konsideron shpalljen e pavarësisë së Kosovës në përputhje me të drejtën ndërkombëtare, qeveria e Republikës arabe të Egjiptit, ka vendosur më 26 qershor 2013 për njohjen e Kosovës si shtet të pavarur dhe sovran", thuhet në deklaratën e zëdhënësit zyrtar të Ministrisë së Punëve të Jashtme të Egjiptit.

Në deklaratë, po ashtu theksohet se Republika arabe e Egjiptit dëshiron me këtë vendim vendosjen e marrëdhënieve të mira me

Republikën e Kosovës në të gjitha fushat, dhe në të njëjtën kohë konfirmon angazhimin e saj për vazhdimin dhe fuqizimin e marrëdhënieve të saj të mira që i lidh gjithmonë me shtetet e rajonit. Ministri i Punëve të Jashtme i Kosovës, Enver Hoxhaj dhe autoritete të tjera të larta të shtetit, kanë zhvilluar aktivitete të shumta lobuese në Egjipt, si rezultat i të cilës dy shtetet kanë konsoliduar raporte shumë të mira për më shumë se dy vjet. Hoxhaj, gjatë kësaj kohe ka vizituar disa herë Kajron dhe në samite të ndryshme të atij rajoni, është takuar me autoritetet më të larta shtetërore, përfshirë ndihmëspresidentin Al-Haddad, ministrin e Jashtëm, Mohamed Kamel Amr, e shumë personalitete të tjera të larta egjiptiane. Njohja e Kosovës nga Egjipti i hap udhë fuqizimit të



gjithanshëm të marrëdhënieve bilaterale ndërshtetërore ndërmjet dy vende dhe popujve, thekson MPJ kosovare në fund të njoftimit.

Kosova shpalli pavarësinë e saj nga Serbia më 17 shkurt të vitit 2008 dhe tashmë njëqind vende e

kanë njohur atë.

Pavarësia e saj kundërshtohet nga Serbia e cila megjithatë është përfshirë në një proces të normalizimit të marrëdhënieve me Kosovën në përpjekje për të siguruar integritetin e saj në Bashkimin Evropian.

Shtyhen bisedimet për anëtarësimin e Turqisë në BE

Gjermania këmbënguli se duhej dërguar një sinjal mosmiratimi nga BE-ja lidhur me shtypjen e protestave anti-qeveritare në Turqi

Bashkimi Evropian ka vendosur të shtyjë për më vonë gjatë këtij viti bisedimet me Ankarën, të cilat synojnë të çojnë përpara procesin e anëtarësimit të Turqisë. Gjermania kishte bërë thirrje për këtë shtyrje, duke thënë se duhej dërguar një sinjal mosmiratimi nga BE-ja lidhur me shtypjen e protestave anti-qeveritare kohët e fundit.

BE-ja kishte planifikuar të rigjallëronte procesin e anëtarësimit të Turqisë në bllokun 27-vendesh. Bisedimet duhet të fillonin sot, duke hapur kështu një kapitull të ri në këtë proces.

Por shtypja e protestave anti-qeveritare në qytete në të gjithë Turqinë ka tronditur shumë vende evropiane. Të udhëhequr nga Gjermania, ministrat e jashtëm të Bashkimit Evropian votuan për të vonuar fillimin e bisedimeve të paktën deri në mes të muajit tetor. "Nga njëra anë, nuk mund të shtiremi sikur negociatat zhvillohen në një vakuum ku ditë e fundit nuk kanë ndodhur. Nga ana tjetër, duhet gjithashtu të sigurohemi që interesat tona të përbashkëta strategjike e afatgjata të jenë të mbrojtura."

Vendimi për shtyrjen e bisedimeve ishte pragmatik, thotë Pawel Swidlicki, një analist i grupit për politikën "Evropa e Hapur", me qendër në Londër.

"Është diçka që shpëton reputacionin e të gjithë të përfshirëve. Askush nuk dëshiron të thotë se ky proces nuk po jep fryte, kështu që kanë rënë dakord të shtyjnë takimet e ardhshme deri pas zgjedhjeve gjermane, sepse kjo do të jetë një çështje e debatueshme në ato zgjedhje."



Zgjedhjet në Gjermani do të zhvillohen në shtator. Konservatorët e kancelares Angela Merkel e kundërshtojnë anëtarësimin e Turqisë në BE edhe në manifestet e tyre elektorale.

Duke folur në Dhomen e Tregtisë gjermano-turke, ajo përsëriti qëndrimin e saj ndaj protestave.

"Nuk dua ta fsheh faktin se u trondita nga disa foto nga Turqia që kemi parë kohët e fundit. Shpresoj që përmes dialogut, në të ardhmen të mund të gjendet një zgjidhje."

Gjatë tre javë përlëshjesh në Stamboll dhe në të gjithë Turqinë katër persona kanë vdekur dhe rreth 7 mijë e 500 janë plagosur. Shumë vende evropiane thonë se reagimi i policisë ka qenë tepër i ashpër.

Por kryeministri Erdogan refuzon të tërhiqet, duke i quajtur veprimet e policisë kohët e fundit si heroike. Zoti Erdogan e humbi interesin në procesin e anëtarësimit në Bashkimin Evropian shumë kohë para se të shpërthenin pro-

testat, thotë Fadi Hakura i institutit të politikave Chatham House.

"Kjo mund të shpjegohet pjesërisht nga kohëzgjatja e tij në detyrë dhe nga fakti që disa vende evropiane, veçanërisht Gjermania dhe Franca, nuk duan që Turqia t'i bashkohet së shpejti bllokut evropian."

Por Britania, së bashku me disa anëtarë të tjerë të BE-së, duan që Turqia të bëhet anëtare e organizatës. Sërisht, zoti Pawel Swidlicki: "Turqia ka potencial të madh ekonomik, në një kohë kur Evropa është e bllokuar politikisht, ekonomikisht dhe demografikisht. Në fakt, ka një sërë sfidash shumë serioze të cilat bëjnë shumë kontrast me dinamizmin e Turqisë."

Ndërkohë, kryebashkiaku i Stambollit ka paralajmëruar se protestat mund t'i kushtojnë qytetit Olimpiket e vitit 2020. Organizatorët do të zgjedhin në shtator qytetin ku do të zhvillohen Lojërat dhe autoritetet e Stambollit janë të shqetësuara se imazhe të tilla do të krijojnë avantazh për kandidatët rivalë si Madridi dhe Tokio.

Kanceri i prostatit, zgjidhja: vaji i ullirit dhe frutat e thata

Meshkujt me kancer në prostat mund ta përballojnë më mirë këtë sëmundje, nëse ata bashkëngjisin në mënyrën e të ushqyerit të tyre, vajë ulliri, fruta të thata dhe avokado, si të dhe reduktojnë e të kufizojnë yndyrat shtazore dhe karbohidratet, sipas një studimi të ri.



Nga studimi rezultoi se të gjithë ata pacientë që kanë zëvendësuar 10% të yndyrave shtazore dhe të karbohidratet me yndyrna të shëndetshme të përmendura më lart, kanë 29% më pak gjasa të vdesin nga përhapja e kancerit, krahasuar me ata që nuk e kanë bërë këtë ndryshim të shëndetshme. Kanë 26% më pak mundësi të vdesin nga çfarëdolloj shkaku tjetër. Për të arritur dikush një rezultat të tillë, nuk duhet të bëjë ndryshime dramatike: qoftë dhe një lugë supe po të hanë më shumë çdo ditë, do të zvogëlohet me 29% rreziku i vdekjes nga kanceri dhe me 13% nga çdo lloj shkaku tjetër, raportojnë studiues amerikanë në revistën shkencore "JAMA Internal Medicine". Studimi u realizua në më shumë se 4.600 meshkuj, pacient me kancer lokal të prostatit, të cilët mjekët i ndoqën me vëmendje shumë të madhe për më shumë se tetë vjet. Ndërkohë, 1,064 prej tyre vdiqën,

me 31% duke humbur jetën e tyre nga sëmundje të zemrës, 21% nga sëmundjet e kancerit të prostatës dhe më pak se 21% e kancereve të tjera. Rezultati përfundimtar ishte se "konsumimi i vajit të ullirit, apo yndyrave të shëndetshme mund të ushtrojë aktivitet mbrojtës", deklaroi mjekja dhe studiuesja Dr Erin Ritsman nga Departamenti i Epidemiologjisë & Biostatistikës, Universiteti i Kalifornisë, San Francisco. Në një koment që shoqëron studimin e ri, Dr Steven Friedland, Profesor i Kirurgjisë, Departamenti i Urologjisë, Universiteti i Dukës, vë në dukje se "Kjo është e dokumentuar mirë se trashja rrit rrezikun e vdekjes nga kanceri i prostatës." Ai vazhdon të theksojë: "Studimi i ri ofron disa dëshmi që reduktimi i yndyrave të ngopura dhe karbohidratet dhe zëvendësimin e tyre me yndyrna të shëndetshme mund të zvogëlojë këtë rrezik."

Lëngu nga pjepr i hidhur shëron tumoret më të rrezikshme

Edhe pse konsumohet tashmë për shekuj të tërë, shumë përparësi shëndetësore (efekti kundër vireuseve, helmeve, parandalimi i diabetit) vetëm para pak kohësh janë bërë të njohura për shëndetësinë perëndimore. Studimi i ri ka zbuluar se lëngu nga pjepr i hidhur, perime kjo e njohur në Azi dhe Afrikë, dukshëm redukton rritjen e tumorit të pankreasit në minj, sepse pengon metabolizmin e glukozës në qelizat e kancerit, si dhe me plot kuptimin e fjalës i bën të uritura pa sheqer, lëndë që i vë në lëvizje pa të cilën nuk mund të mbijetojnë. Tashmë janë të njohura dobi të shumta shëndetësore që lidhen me konsumimin e pjeprit të hidhur. Kjo bimë, me emrin latin 'Momordica charanna', kultivohet dhe konsumohet shumë në Azinë juglindore, në Afrikë, Kinë, Japoni, Oqeani, e madje edhe në Karaibe. Veçanërisht e popullar-

izuar është në mesin e japonezëve nga Okinava, të cilët janë të njohur për jetëgjatësi. Në katër vitet e fundit në mënyrë intensive është duke u analizuar efekti i kësaj bime kundër kancerit. Efekti antikoncepcionit është i dukshëm edhe te kanceri i gjirit, prostatës, zorrës së trashë, mëlçisë, lukthit dhe tumorëve naso-faringale, si dhe në rastet e leukemisë dhe neuroblastomëve. Studimi më i ri ka zbuluar se pjepr i hidhur ka ndikim citotoksik në kancerin e pankreasit. Njerëzit që peshojnë 75 kilogramë duhet të konsumojnë 6 gramë të këtij pluhuri. Doza e ngjashme prej 4.8 gramëve të lëngut të ngrirë është përdorur në kuadër të një studimi të para pak kohësh. Në fakt, tre muaj u është dhënë pacientëve nga sindroma metabolike. Ilaçi ka pasur efekt dhe të gjithë pacientët kryesisht e kanë përballuar mirë atë.